

PROGRAMI I KURSIT

“Orjentimi për karrierrën dhe sipërmarrjen”

(Kodi: PK-L-1-16)

Tiranë, Janar 2016

Ky program kursi u mundësua nga **Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"** në kuadrin e programit **SEED – "Mbështetje për Zhvillimin e Edukimit dhe Punësimit në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi"** 2014-2016, në partneritet me **Volkshilfe Solidarität**, Austri dhe me mbështetjen e **Agjensisë së Kooperacionit Austriak për Zhvillim**.

Grupi Drejtues i Programit të Kursit:

MA. Fabiola Laço Egro, Drejtore Kombëtare për programin, Drejtore Ekzekutive "Sot për të Ardhmen"

MA. Sonila Limaj, Drejtore e Agjensisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

Grupi hartues i Programit të Kursit:

Dr. Mirela Andoni

Ines Todhe

Merita Shuke

Moderatore: Dr. Mirela Andoni

PROGRAMI I KURSIT

“Orjentimin për karrierrën dhe sipërmarrjen ” (PK-L-1-16)

I. Profili i përgjithshëm i kursit “Orjentiimi për karrierrën dhe sipërmarrjen”

a) Karakteristikat e kursit

Ky është një kurs në mbështetje të rinjve apo edhe të rriturve me qëllim vetëorjentimin për gjatë gjithë jetës për karrierrën dhe sipërmarrjen.

Konsideruar ndryshimet e vazhdueshme të tregut të punës si një sfidë që çdo individ e ndesh gjatë jetës së tij, për këtë arsye aftësitë e duhura për ta orjentuuar në momentet që duhet të marrë vendime për të përcaktuar drejtimin e jetës së ardhshme profesionale dhe shoqërore janë vendimtare.

Ky kur mund t’ ofrohet të rinjve që sapo kanë mbaruar një shkollim të mesëm apo edhe të papunëve të rritur që kërkojnë të integrohen në tregun e punës, të vazhdojnë të kualifikohen në kurse të shkurtra profesionale ose post-sekondare, apo të vijojnë studimet e mëtejshme në universitet (brenda ose jashtë vendit). Marrja e një vendimi të drejtë në lidhje me këto opsione nuk është e lehtë dhe kërkon analizën e shumë faktorëve.

Punësimi dhe vetëpunësimi kërkon gjithashtu aftësitë e duhura jo vetëm për të kërkuar një punë por edhe për hapjen e një biznesi personal, familjar, etj.

Përmes këtij kursi synohet zhvillimi i aftësive për të komunikuar si duhet apo analizuar mundësitë e punësimit dhe qëllimeve personale të karrierës referuar prirjeve të vendeve të punës, në një ekonomi globale dhe lokale. Gjithashtu njohuritë dhe aftësitë për të njohur dhe planifikuar burimet financiare, për të njohur aspekte të legjislacionit për të hapur një biznes apo llogaritjet e thjeshta të kostove apo kontabiliteti i biznesit janë pjesë e kursit që do të ndihmojnë pjesëmarrësit për të planifikuar dhe zhvilluar një ide sipërmarrëse.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Orjentiimi për karrierrën dhe sipërmarrjen”

Në përfundim të Kursit, kursantët do të jenë të aftë të:

- zbatojnë rregullat e komunikimit
- zbatojnë etikën sipas rastit të komunikimit
- evidentojë cilësitë, dëshirat, prirjet, përvojat personale;
- shkruajë CV-në personale
- analizojë prirjet e tregut të punës në rajonin ku jeton dhe më gjerë
- bëjë planin e karrierës
- tregojë me shembuj mënyra të administrimit të financave personale
- dallojë institucionet kryesore financiare dhe instrumentet e tyre
- dallojë kuptimin mbi të drejtën e biznesit
- kryejë veprime të thjeshta të kostos dhe çmimit
- përcaktojë objektiva të sipërmarrjes dhe treguesit për menaxhim

- interpreton kontabilitetin e sipërmarrjes

III. Kërkesat e pranimit në Kurs

Pjesmarrësit duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë të aftë fizikisht e mendërisht.

IV. Kohëzgjatja e Kursit

Kursi ka një kohëzgjatje prej 40 orësh mësimore, ku 1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Vetëorjentimi për karrierën	MK-17-030-16	15 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti shpjegon dhe kryen procedura të hulumtimit për karrierën 2. Kursanti përgatit informacionin për vetveten 3. Kursanti harton plane dhe merr vendim.
2	Menaxhimi i financave personale	MK-17-031-16	10 orë mësimore Rekomandohet: 10 % Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan institucionet financiare, funksionet dhe instrumentet e tyre në tregun financiar 2. Kursanti kryen veprime të administrimit të financave vetjake
3	Baza të sipërmarrjes	MK-17-032-16	15 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan të drejtën e biznesit 2. Kursanti kryen veprime të llogaritjes së kostos dhe çmimit 3. Kursanti përcakton objektivat e sipërmarrjes dhe treguesit e menaxhimit 4. Kursanti interpreton kontabilitetin e sipërmarrjes

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktoret e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MMSR.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit

1. Moduli “Vetëorjentimi për karrierën”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	VETËORJENTIMI PËR KARRIERRËN	MK-17-030-16
Qëllimi i modulit	Një modul që zhvillon te kursanti aftësi për të identifikuar dhe hulumtuar qëllimet e karrierës, për të zhvilluar aftësitë punë kërkuese, për të planifikuar dhe marrë vendim për shkollimin/trajnimin e mëtejshëm dhe punësimin	
Kohëzgjatja e modulit	15 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti shpjegon dhe kryen procedura të hulumtimit për karrierën Përmbajtja: - Puna, profesioni, karriera dhe kualifikimi i përgjithshëm dhe profesional; - Sistemin formal, informal, joformal të kualifikimit në Shqipëri; - Burimet e punësimit në tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar të punësimit; - Shërbimet sociale dhe zyrat e punësimit; - Profesionet që lidhen me veprimtaritë e shërbimit dhe ato të prodhimit në tregun lokal; Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë me shembuj lidhjet dhe ndryshimet midis punës, profesionit dhe karrierës; - të shpjegojë kuptimin dhe rëndësinë e kualifikimit në përgjithësi dhe atij profesional, në lidhje me statusin e punësimit; - të shpjegojë sistemin formal, informal, joformal të kualifikimit në Shqipëri; - të diskutojë ndikimin e kualifikimit në zhvillimin e karrierës;	

-
- të paraqesë prirjet e zhvillimit të punësimit në tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
 - të paraqesë burimet kryesore të punësimit në tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar të punësimit;
 - të identifikojë shërbimet kryesore sociale dhe zyrat e punësimit në tregun lokal;
 - të shpjegojë statusin e individëve në tregun e punës (i punësuar, i papunë, student, etj).
 - të listojë forma të ndryshme të ndihmës për të papunët;
 - të paraqesë shërbimet që ofrojnë zyrat e punësimit dhe ndihmës sociale në tregun lokal;
 - të paraqesë veprimtaritë ekonomike në tregun lokal;
 - të identifikojë profesionet që lidhen me veprimtaritë e shërbimit dhe ato të prodhimit në tregun lokal;
 - të argumentojë ndryshimet midis veprimtarive të ndryshme të punës;

RM 2 Kursanti përgatit informacionin për vetveten

Përmbajtja:

- Interesat, dëshirat personale për profesione të ndryshme
- Vetëvlerësimi i aftësive, prirjeve personale të nevojshme në lidhje me profesionet;
- Ndikimi i rolit gjinor në profesionet e përzgjedhura;
- Rëndësia e komunikimit, veshjes, paraqitjes, sjelljes në mjediset e punës;
- Tiparet, faktorët që ndikojnë në karriera të suksesshme;
- Vendim-marrja, menaxhimi i kohës, stresi, konfliktet, planifikimi, etj, në suksesin në karrierë;
- Tiparet personale për të patur karrierë të suksesshme në profesione të përzgjedhura.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të identifikojë interesat dhe dëshirat personale për profesione të ndryshme
- të argumentojë interesat dhe dëshirat personale për profesione të ndryshme.
- të bëjë vetëvlerësimin duke mbajtur parasysh dëshirat dhe interesat që lidhen me profesione të ndryshme;
- të vlerësojë/rivlerësojë aftësitë dhe prirjet personale të nevojshme në lidhje me profesionet e përzgjedhura;
- të vlerësojë ndikimin e rolit gjinor në profesionet e përzgjedhura;
- të paraqesë shembuj nga realiteti lidhur me ndikimet e rolit gjinor në tregun e punës;
- të identifikojë aspekte të sensualitetit, seksualitetit, intimitetit në raport me profesionet e përzgjedhura;
- të paraqesë nëpërmjet shembujve ndikimin e sensualitetit, seksualitetit, intimitetit në raport me profesionet e përzgjedhura;
- të shpjegojë me shembuj rëndësinë e komunikimit, veshjes, paraqitjes,

- sjelljes në mjediset e punës;
- të identifikojë tipare, faktorë që ndikojnë në karriera të suksesshme;
- të shpjegojë me shembuj si ndikojnë vendim-marrja, menaxhimi i kohës, stresi, konfliktet, planifikimi, etj, në suksesin në karrierë;
- të listojë tiparet personale për të patur karrierë të suksesshme në profesione të përzgjedhura.
- të vlerësojë profesionet e përzgjedhura duke bërë dallimin mes objektivitetit dhe paragjykit

RM 3 Kursanti harton plane dhe merr vendim

Përmbajtja:

- Kërkimi i punës nëpërmjet letërkërkesës, telefonit, në formë elektronike, formave të gatshme të aplikimit;
- Rregullat për hartimin e një “curriculum vitae”;
- Intervista për punë;
- Përgatitja për intervistë;
- Komunikimi dhe etika gjatë intervistës;
- Procesi i planifikimit të karrierës;
- Buxheti personal lidhur me karrierën;
- Strategjitë për karrierën personale;
- Portofoli i karrierës;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të hartojë kërkesën për punë nëpërmjet letërkërkesës;
- të hartojë kërkesën për punë nëpërmjet telefonit;
- të hartojë kërkesën për punë në formë elektronike;
- të plotësojë forma të gatshme aplikimi për punë;
- të hartojë një “curriculum vitae” sipas formateve të qarta dhe konsistente, me gjuhë të qartë duke vënë në dukje (në formë imagjinare), aftësitë, cilësitë personale;
- të shpjegojë llojet e intervistave për punë;
- të shpjegojë hapat e përgatitjes për intervistën e punës (parapërgatitja, intervista, reflektimi);
- të paraqesë procesin e parapërgatitjes për intervistë;
- të paraqesë rregullat e komunikimit dhe etikën gjatë intervistës;
- të paraqesë reflektimin në lidhje me intervistën;
- të demonstrojë në një rast të simuluar interviste;
- të shpjegojë procesin e planifikimit të karrierës;
- të analizojë nëpërmjet analizës SWOT informacionin e mbledhur për të arritur në vendim marrje;
- të shpjegojë procesin e vendimarrjes për karrierën;
- të hartojë qëllimin dhe objektivat për karrierën;
- të planifikojë afatet kohore për çdo objektiv për karrierën;
- të planifikojë buxhetin personal lidhur me karrierën;
- të planifikojë strategjitë për karrierën personale;
- të listojë elementet përbërës të portofolit për karrierën;
- të plotësojë portofolin për karrierën sipas rubrikave;

Udhëzime për

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise klase.

zbatimin e modulit	- Për realizimin e modulit kursanti është i detyruar të kryejë të dyja rezultatet mësimore të parashikuara në modul.. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime të shembujve konkretë. - Kursantit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me përvoja konkrete nga familja apo edhe personale. - Gjatë vlerësimit të kursantit duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për planifikimin dhe vendimarrjen e karrierës. Portofoli i kursantit, sugjerohet si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen dhe materialet e mëposhtme: - Materiale mbështetëse. - Katallogë, manuale, udhëzuesë, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Menaxhimi i financave personale”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MENAXHIMI I FINANCAVE PERSONALE	MK-17-031-16
Qëllimi i modulit	Një modul që zhvillon te Kursanti njohuri të thjeshta ekonomike dhe financiare si dhe i aftëson ata të jenë qytetarë të vetëdijshëm për të marrë vendime financiare duke vlerësuar kostot dhe përfitimet si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre si konsumatorë në tregun financiar.	
Kohëzgjatja e modulit	10 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan institucionet financiare, funksionet dhe instrumentet e tyre në tregun financiar Përmbajtja: - Kuptimi për kulturën financiare. - Tiparet e ekonomisë shqiptare. - Mjedisi financiar, politika fiskale dhe monetare. - Institucionet financiare, funksionet dhe politikat. - Shërbimet financiare Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë e kuptimin dhe rëndësinë e kulturës financiare; - të analizojë ndikimin që kanë vendimet financiare në standardin e jetesës së qytetareve; - të përshkruajë tiparet e ekonomisë shqiptare; - të shpjegojë kuptimin mbi mjedisin financiar; - të dallojë institucionet financiare, funksionet dhe politikat e tyre; - të bëjë dallimin mes politikës fiskale dhe asaj monetare; - të shpjegojë të drejtat dhe detyrimet e individit si konsumator i shërbimeve financiare;	

RM 2 Kursanti kryen veprime të administrimit të financave vetjake
Përmbajtja:

- Vlrera monetare e parasë.
- Inflacioni dhe kursi i këmbimit të parasë.
- Produktet dhe shërbimet bankare.
- Llojet e llogarive dhe depozitat bankare, norma e interesit.
- Llogaritë e kursimit, rrjedhëse dhe kredia.
- Kartat bankare
- Skema e sigurimit të depozitave;
- Kostot dhe përfitimet e kursimit dhe të huamarrjes;
- Raporti mes taksave, kontributeve të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore dhe të ardhurave vetjake;
- Procedura e hartimit të buxhetit vetjak dhe plani i kursimit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë kuptimin mbi vlerën monetare të parasë;
- të analizojë efektet e inflacionit dhe të kursit të këmbimit mbi vlerën e parasë;
- të analizoje ndikimin e inflacionit në vendimmarrjet mbi financat vetjake;
- të përshkruajë llojet e produkteve dhe shërbimeve bankare;
- të shpjegojë kushtet për çeljen e një llogarie kursimi/rrjedhëse/ për përfitimin e një kredie;
- të përshkruajë kuptimin mbi llojet e llogarive dhe depozitave bankare;
- të llogarisë përfitimet nga depozita me afate dhe norma interesi të ndryshme;
- të krahasojë kostot dhe përfitimet nga përdorimi i depozitave të ndryshme;
- të shpjegojë dallimin mes kartave bankare, përfitimet dhe kostot e përdorimit të tyre;
- të shpjegojë skemën e sigurimit të depozitave si mbështetje dhe nxitje për kurse te sigurta;
- të analizoje kostot dhe përfitimet e kursimit;
- të analizoje kostot dhe përfitimet e huamarrjes;
- të dallojë ndikimin në të ardhurat vetjake të taksave, kontributeve të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore;
- të dallojë ndikimin e taksave dhe tatimeve të pushtetit vendor në të ardhurat vetjake;
- të hartojë buxhetin vetjak;
- të vlerësojë ndjekjen/ zbatimin e bu e buxhetit vetjak;
- të hartojë plan kursimi;

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise të klasës.
- Për realizimin e modulit Kursanti është i detyruar të kryejë të dyja rezultatet mësimore të parashikuara në modul..
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime të shembujve konkretë.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete. Ata

	duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me raste të administrimit të financave vetjake. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për veprimet financiare të parashikuara në modul. Portofoli i kursantëve, sugjerohet si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen dhe materialet e mëposhtme: - Materialembështetëse dhe fletë palosje të bankave. - Katallogë, manuale, udhëzuesë, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Baza të sipërmarrjes”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	BAZA TË SIPËRMARRJES	MK-17-032-16
Qëllimi i modulit	Një modul që zhvillon te kursantët njohuri dhe aftësi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e një biznesi me qëllim aftësimin e tyre për sipërmarrjen e biznesit.	
Kohëzgjatja e modulit	15 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan të drejtën e biznesit <i>Përmbajtja:</i> - Forma ligjore të organizimit të biznesit. - “Përgjegjësia personale e pakufizuar” - “Vlerë nominale”, “vlerë e tregut të një aksioni”, “divident” duke e argumentuar me shembuj. - Elementet e domosdoshme bazë të një kontrate shitjeje - Përfaqësimi për format e ndryshme ligjore të organizimit të biznesit. - “Prokurë” (caktimi, autorizimi) - “Rregjistri tregtar” <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> - Pyetje-përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë: - Të shpjegojë arsyet e egzistencës së formave të ndryshme ligjore të organizimit të biznesit. - Të klasifikojë format individuale të organizimit të biznesit. - Të shpjegojë kuptimin për “përgjegjësinë personale e pakufizuar” duke argumentuar me shembuj nga realiteti. - Të shpjegojë termat “vlerë nominale”, “vlerë e tregut të një aksioni”, “divident” duke e argumentuar me shembuj. - Të shpjegojë elementet e domosdoshme bazë të një kontrate shitjeje - Të dallojë kriteret për një nënshkrim ligjërisht detyrues. - Të shpjegojë rregullat baze të përfaqësimit për format e ndryshme ligjore të organizimit të biznesit. - Të përcaktojë dhe shpjegojë termin “prokurë”	

(caktimi, autorizimi)

- Të përshkruajë karakteristikat kryesore të një “regjistri tregtar”
- Të shpjegojë këto karakteristika në lidhje me organizimin e biznesit.

RM 2 Kursanti kryen veprime të llogaritjes së kostos dhe çmimit
Përmbajtja:

- Objektivat për kontabilitetin e kostos.
- Kontabiliteti financiar dhe kontabiliteti i kostos.
- “Elementet e kostos”.
- Faktorët që ndikojnë në çmimin e një produkti.
- Kërkesa dhe oferta dhe konceptin e “çmimit të tregut”.
- Format e ndryshme të tregut (monopol, oligopoli, konkurrencë e plotë)
- Marzhet e ndryshme çmimi.
- Llogaritja e kostove për çdo zë
- Procedura e hartimit të buxhetit vetjak dhe plani i kursimit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- Të shpjegojë dhe të përcaktojë objektivat për kontabilitetin e kostos.
- Të shpjegojë dallimin ndërmjet kontabilitetit financiar dhe kontabilitetit të kostos.
- Të përcaktojë dhe të shpjegojë termin “elementet e kostos” dhe të japë shembuj.
- Të shpjegojë faktorët që ndikojnë në mënyrë domethënëse në çmimin e një produkti.
- Të shpjegojë ndërveprimin ndërmjet kërkesës dhe ofertës dhe konceptin e “çmimit të tregut”.
- Të përcaktojë dhe të shpjegojë format e ndryshme të tregut (monopol, oligopoli, konkurrencë e plotë)
- Të atribuojë marzhe të ndryshme çmimi ndaj formave përkatëse të tregut dhe të japë arsye për vendimet tuaja.
- Të shpjegojë qëllimin e fletës për shpërndarjen e kostove dhe të riprodhojë strukturën e saj bazë.
- Të llogarisë kostot për çdo zë kostoje

RM 3 Kursanti përcakton objektivat e sipërmarrjes dhe treguesit e menaxhimit

Përmbajtja:

- Kuptimi mbi “përfitueshmërinë”
- Kuptimi mbi “kthim nga kapitali i vet”
- Kuptimi mbi “kthim nga investimi (ROI)”
- Kuptimi mbi “likuiditet;
- Kuptimi mbi “aktive likuide” në pasqyrat financiare vjetore.
- Kuptimi mbi “raporti i kapitalit të vet”

- Kuptimi mbi “raporti borxh –kapital”
- Kuptimi mbi “fluks i parave”
- Kuptimi mbi “produktivitet”

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- Të shpjegojë termin “përfitueshmëri”
- Të shpjegojë termin “kthim nga kapitali i vet”
- Të shpjegojë nëse të krijosh fitim automatikisht do të thotë që një shoqëri është “fitimprurëse”
- Të vlerësojë dhe të klasifikojë çdo kthim të arritur nga kapitali i vet
- Të shpjegojë termin “kthim nga investimi (ROI)”
- Të shpjegojë termin “likuiditet”.
- Të shpjegojë termin “aktive likuide” dhe të identifikojë ato saktë në pasqyrat financiare vjetore.
- Të shpjegojë termin “raporti i kapitalit të vet”
- Të shpjegojë termin “raporti borxh –kapital”
- Të përcaktojë dhe të shpjegojë termin “fluks i parave”
- Të përcaktojë dhe të shpjegojë termin “produktivitet”
- Të shpjegojë pse arritja e një produktiviteti të lartë është shumë e rëndësishme për një shoqëri.

RM 4 Kursanti interpreton kontabilitetin e sipërmarrjes

Përmbajtja:

- Pasqyrat financiare vjetore (bilanci,pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve –A&Sh)
- Struktura baze e një bilanci
- Kuptimi mbi “ana e aktiveve”, “aktive afatgjata dhe afatshkurtër, “ana e pasiveve dhe e kapitalit”.
- Përgatitja e një inventari

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- Të shpjegojë qëllimin e pasqyrave financiare vjetore (bilanci,pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve –A&Sh)
- Të dallojë rëndësinë e pasqyrave financiare vjetore.
- Të shpjegojë strukturen baze të një bilanci
- Të shpjegojë termat “ana e aktiveve”, “aktive afatgjata dhe afatshkurtër” .
- Të shpjegojë termin “ana e pasiveve dhe e kapitalit”.
- Të shpjegojë qëllimin e përgatitjes së një inventari dhe hapat për përgatitjen e tij.
- Të shpjegojë termat më të rëndësishëm të pasqyrës së të Ardhurave dhe Shpenzimeve (A&SH)
- Të shpjegojë pse pasqyrat financiare vjetore mund të përmbajnë transaksione, të cilat aktivitetit (periudhë kontabël)
- Të përcaktojë termin “llogari të arkëtueshme” dhe të identifikojë ato saktë në pasqyrat financiare vjetore.

- Të përcaktojë termin “provizione” dhe të identifikojë ato saktë në pasqyrat financiare vjetore.
- Të përcaktojë termin “rezerva” dhe të identifikojë ato saktë në pasqyrat financiare vjetore.
- Të përcaktojë dhe të shpjegojë termin “amortizim”
- Të shpjegojë termin “shpenzime kapitale apo për t’u kapitalizuar”
Të lexojë pasqyra financiare të thjeshta dhe të nxjerrë konkluzione bazë nga ato (rast studimor).

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise të klasës. - Për realizimin e modulit Kursanti është i detyruar të kryejë të dyja rezultatet mësimore të parashikuara në modul.. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime të shembujve konkretë. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me raste të sipërmarrjeve imagjinare vetjake vetjake. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për veprimet financiare të parashikuara në modul. Portofoli i kursantëve, sugjerohet si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
--	---

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen dhe materialet e mëposhtme: - Materiale mbështetëse dhe fletë palosje të bankave. - Katallogë, manuale, udhëzuesë, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
---	--